



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Raporti vjetor Godišnji izveštaj Annual Report 2015



Prishtinë, 2016



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

RAPORTI VJETOR
GODIŠNJI IZVEŠTAJ
ANNUAL REPORT
2015

Prishtinë, 2016

RAPORTI VJETOR 2015

Përmbajtja

Përmbajtja.....	5
VIZIONI DHE MISIONI.....	7
FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE	9
FJALA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM,	11
RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2015.....	12
SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE	14
I. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE (DABNJ)	17
II. DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE (DPP)	25
III. DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA).....	29
IV. DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE (DBF).....	37
V. NJËSIA E PROKURIMIT (NJP)	43
VI. NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MULTIMEDIAVE (NJTIKM)	47
VII. AUDITIMI	51
VIII. NJËSIA LIGJORE (NJL).....	55
IX. ZYRA PER KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKI)	59
X. AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE	63
SHTOJCA	73
ORGANOGRAMI	77

VIZIONI DHE MISIONI

1. Vizioni

Republika e Kosovës është shtet demokratik, i bazuar në sundimin e ligjit dhe në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të dinjitetit njerëzor, të garantuara me Kushtetutë. Në Kosovë, ku qytetarët vendosin nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, të cilët janë përgjegjës para tyre, Gjykata Kushtetuese është një institucion i cili është autoriteti përfundimtar dhe garantues e Kushtetutës dhe respektimit të ligjit.

E drejtuar nga Kushtetuta, Gjykata i kontribuon: (1) ndërtimit të një shteti të lirë, demokratik dhe paqedashës; (2) garantimit të të drejtave të secilit qytetar, lirive qytetare dhe barazisë së të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve para ligjit; dhe (3) eliminimit të gjurmëve të së kaluarës, duke krijuar tradita të reja juridike, të bazuara në sundimin e ligjit, në demokraci dhe në të drejta të njeriut.

2. Misioni

Si institucion i ri në demokraci të re, Gjykata Kushtetuese ka një rol të rëndësishëm në përmbushjen e vizionit të lartpërmendur. Megjithatë, Gjykata ballafaqohet me sfida të konsiderueshme ndaj përmbushjes së këtij roli, sepse ndryshimet e brendshme nuk janë të mjaftueshme. Gjykata, po ashtu, duhet të inkurajojë ndryshimet e jashtme. Këto dy aspekte janë të ndërlidhura ngushtë njëra me tjetrën. Vizioni nuk mund të arrihet pa një zhvillim të arsyeshëm të brendshëm të Gjykatës dhe ndikimit të ndërsjellë ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe sinergjive të jashtme shoqërore, ekonomike, kulturore dhe teknologjike.

Si rrjedhojë e kësaj, në pajtim me këtë vizion, Gjykata Kushtetuese e Kosovës i ka parashtruar vetes mision që të jetë:

Institucion profesional, kompetent dhe i pavarur, që është duke krijuar një traditë të re të paanshmërisë dhe të pavarësisë gjyqësore, si dhe të llogaridhënies së plotë në shërbim të qytetarëve të Kosovës;

Institucion transparent, që mbron me sukses të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve dhe të komuniteteve të Kosovës, duke gjykuar në mënyrë të drejtë dhe transparente, brenda juridiksionit të saj, dhe duke mbikëqyrur drejtësinë në ushtrimin dhe në përdorimin e kompetencave të përcaktuara nga Kushtetuta; dhe

Autoritet përfundimtar i rendit kushtetues të vendit, duke siguruar dhe duke mbështetur tranzicionin e Kosovës drejt të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit.

FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE, ARTA RAMA HAJRIZI

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë të prezantoj Raportin vjetor të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2015. Sikurse edhe raportet pararendëse vjetore, ky raport vjetor ofron një pasqyrë të aktiviteteve të Gjykatës gjatë vitit të kaluar, me fokus të veçantë në punën dhe në rezultatet e secilit departament dhe të secilës njësi të administratës së Gjykatës Kushtetuese.

Raporti përmban, ndër të tjera, të dhëna të përmbledhura statistikore përkitazi me numrin e lëndëve të trajtuara, seancat e mbajtura, kërkesat e parashtruara, shkeljet e supozuara, shpenzimet buxhetore, aktivitetet e prokurimit, auditimin e brendshëm, numrin e përgjithshëm të të punësuarve, konferencat dhe punëtoritë e organizuara, si dhe vizitat e realizuara në vend dhe jashtë vendit, të cilat përveç se janë dëshmi e punës së kryer me përkushtim dhe me profesionalizëm nga gjyqtarët dhe nga stafi i Gjykatës, janë edhe motiv shtesë për angazhim të mëtejshëm në tejkalimin e sfidave në të ardhmen.

Për profesionalizmin dhe për dedikimin e treguar në punë gjatë vitit të kaluar, me synim për të çuar përpara objektivat e Gjykatës, dëshiroj t'i falënderoj nga zemra të gjithë gjyqtarët, Sekretarin e Përgjithshëm, këshilltarët juridikë dhe zyrtarët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese.

Falë punës së përbashkët, Gjykata tejkaloi me sukses një sërë sfidash gjatë vitit 2015 dhe vendosi për një sërë rastesh të rëndësishme, gjithmonë duke marrë parasysh jurisprudencën relevante të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga rastet më të rëndësishme që u shqyrtuan, ka qenë kërkesa për rastin KO130/15, e parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 84 (9) të Kushtetutës, me të cilën u kërkuar vlerësimi i pajtueshmërisë së dokumentit të titulluar *“Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë – Parimet e përgjithshme/elementet kryesore”* me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Një kërkesë tjetër e rëndësishme ishte KO26/15, e parashtruar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës, me të cilën u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Amendamentit nr. 24 të Kushtetutës, i propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i cili përmbante katër elemente strukturore që ndërliiden me sistemin e drejtësisë të Republikës së Kosovës, përkatësisht me themelimin e Dhomave të Specializuara, Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese dhe emërimin e Ombudspersonit të veçantë, me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Përkitazi me llojllojshmërinë e rasteve të shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese gjatë vitit të kaluar dhe me numrin e tyre përgjithshëm, mund t'i referoheni të dhënave të prezantuara më gjerësisht në këtë raport vjetor.

Në vitin 2015, krahas punës së bërë në shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga palët e autorizuar, unë dhe gjyqtarët e Gjykatës zhvilluam edhe vizita zyrtare në gjykata kushtetuese dhe në institucione të tjera shtetërore prestigjioze të vendeve fqinje, me qëllim të shkëmbimit të ideve dhe të përvojave në drejtësinë kushtetuese dhe me qëllim të marrëdhënieve profesionale e miqësore me këto institucione.

Më 17 tetor 2015, Gjykata Kushtetuese organizoi ceremoninë solemne të Vitit të Gjashtë Gjyqësor të Gjykatës, në praninë e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, të kryetarëve dhe të gjyqtarëve të këtyre gjykatave kushtetuese: të Lituanisë, të Turqisë, të

Sllovenisë, të Bullgarisë, të Malit të Zi dhe të Maqedonisë, si dhe në prani të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë.


Në ceremoninë e Vitit Gjyqësor të Gjykatës, mori pjesë edhe një delegacion nga Komisioni i Venecias, i prirë nga presidenti i Komisionit, z. Gianni Buquicchio, që ishte edhe njëri nga folësit kryesor në ceremoninë solemne.

Përfitoj nga rasti që, në fund, të shpreh falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për të gjithë partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë të Gjykatës, e në veçanti për Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), për Agjencinë Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar (GIZ), për Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (IRZ) dhe për Zyrën e Këshillit të Evropës në Kosovë, që, sikurse edhe në vitet e kaluara, ofruan mbështetje të çmuar dhe të vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve të Gjykatës nëpërmjet punëtorive, seminareve dhe aktiviteteve të tjera trajnuese.

Më 3 dhe 4 nëntor 2015, së bashku me gjyqtarët dhe me këshilltarët e Gjykatës, qëndruam për vizitë zyrtare në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, ku edhe patëm privilegjin e pjesëmarrjes në njërën nga seancat dëgjimore që u mbajt në Dhomën e Madhe të kësaj gjykate.

Gjykata Kushtetuese dhe gjyqtarët e saj do të vazhdojnë të kryejnë me përgjegjësi dhe me devotshmëri punën e tyre për mbrojtjen e kushtetutshmërisë në vend, në përputhje me misionin e dhënë dhe gjithmonë duke i qëndruar besnike Kushtetutës së Kosovës.

Arta Rama-Hajrizi



Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

FJALA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM, MILOT VOKSHI

Kam kënaqësinë e veçantë të paraqes Raportin vjetor 2015 të punës së Sekretariatit të Gjykatës. Sekretariati mbështet Gjykatën Kushtetuese dhe siguron funksionimin efikas dhe efektiv të administratës së Gjykatës.

Raporti pasqyron aktivitetet e zhvilluara nga Sekretariati i Gjykatës, i cili është angazhuar me përkushtim të madh në drejtim të arritjes së objektivave të punës dhe përmbylljes me sukses të projekteve të parashikuara në Planin e punës për vitin 2015, si dhe në Planin Strategjik të Gjykatës për periudhën 2014-2017.

Në mënyrë të veçantë, Sekretariati ka qenë i fokusuar në sigurimin e një performance sa më të lartë të Sekretariatit brenda përgjegjësive që ka, domethënë në shpalljen dhe plotësimin e pozitave të punës, në aftësimin dhe në ngritjen e mëtejme të kapaciteteve profesionale të personelit dhe në zhvillimin, në hartimin e në zbatimin e mëtejme të rregullave dhe të procedurave të punës.

Sekretariati ka tejkaluar me sukses ballafaqimin me sfidat dhe i ka arritur plotësisht objektivat e punës në zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara dhe realizimin e synimeve të parapara në afate kohore.

Përmbushja e objektivave të identifikuara është fryt i punës ekipore të personelit të Sekretariatit. Prandaj, sikurse edhe në vitet që shkuan, përfitoj nga rasti t'i shpreh mirënjohje gjithë personelit të Sekretariatit për kontributin e dhënë dhe për rezultatet e arritura në zbatimin e planeve të punës, si dhe në sigurimin e funksionimit me efektivitet dhe efikasitet të lartë të Gjykatës.

Një falënderim të veçantë e meritojnë donatorët, të cilët, edhe në vitin 2015, me asistencën e tyre, ndikuan në arritjen e sukseseve të përgjithshme të Gjykatës.

Veçmas, në emrin tim dhe në emër të stafit të Sekretariatit, falënderoj gjyqtarët dhe kryetaren e Gjykatës, mr. sc. Arta Rama Hajrizi për inkurajimin, për përkrahjen dhe për mbështetjen pa rezervë, si dhe për udhëzimet e qarta dhe profesionale që na kanë ofruar në tejkalimin e sfidave, përderisa përkushtimi i pashembullt dhe profesionalizimi i tyre, i treguar në interpretimin e Kushtetutës, vazhdon ta mbajë Gjykatën Kushtetuese ndër institucionet më të fuqishme, më të respektuara dhe me besueshmërinë më të lartë në vend.

Sekretariati do të mbetet i përkushtuar në zbatimin e Planit Strategjik për periudhën 2014-2017.

Milot Vokshi

Sekretar i Përgjithshëm

RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2015

Hyrje

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Kushtetuese ose GJK-ja) është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë të saj.

Gjykata Kushtetuese ka vendosur për 126 kërkesa, të cilat i janë parashtruar Gjykatës në vitin 2014, i ka publikuar vendimet për to në faqen e internetit të Gjykatës, dhe ua ka dorëzuar ato palëve. Krahas kësaj, të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese u publikuan në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


Në pajtim me nenin 115.2 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 14 (3) i të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës), Gjykata Kushtetuese aprovoi raportin e saj vjetor për vitin 2015, në seancën administrative të mbajtur më 15 prill 2016.

Në pajtim me nenin 115.2 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 14 të Rregullores së punës, Sekretariati organizoi mbarrëvajtjen e 8 (tetë) seancave administrative, ku u morën 31 (tridhjetë e një) vendime. Ndër vendimet më të rëndësishme ishin:

- Aprovimi i Raportit vjetor për vitin 2014;
- Zgjedhja e Kryetares së re të Gjykatës;
- Aprovimi i Planit të punës për Sekretarin e Përgjithshëm për vitin 2015.

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar,
Robert Carolan, gjyqtar,
Altay Suroy, gjyqtar,
Almiro Rodrigues, gjyqtar,
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.



**Mr. sc. Arta Rama-Hajrizi,
kryetare**



**Prof. Dr. Ivan
Čukalović,
zëvendëskryetar**



**Robert Carolan
J.D., gjyqtar**




**Dr. Altay Suroy,
gjyqtar**




**Dr. Almiro
Rodrigues, gjyqtar**




**Prof. dr. Snezhana
Botusharova-
Doicheva, gjyqtare**



**Mr. sc. Bekim Sejdiu,
gjyqtar**



**Selvete Gerxhaliu-
Krasniqi,
gjyqtare**



**Gresa Caka Nimani,
gjyqtare**

SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Kompetencat e Sekretariatit

Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Sekretariati) udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili, sipas nenit 12.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Gjykatën) është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretarisë. Struktura organizative e Sekretariatit përbëhet nga:

- Departamenti i Administratës dhe i Burimeve Njerëzore (DABNJ);
- Departamenti për Regjistrim të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv (DRLSA);
- Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP);
- Departamenti për Buxhet dhe Financa (DBF);
- Njësia e Prokurimit (NJP);
- Njësia e Teknologjisë së Informacionit, e Komunikimit dhe e Multimedieve (NJTIKM);
- Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB); dhe
- Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI).

Plani Strategjik i Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2014-2017 parashikonte zhvillimin e 77 aktiviteteve gjatë vitit 2015. 73 prej tyre janë realizuar me sukses.

Njësia Ligjore (NJL) përfshin pozitat e këshilltarëve juridikë dhe personelin tjetër ligjor. Struktura dhe organizimi i saj rregullohen me Udhëzimin për praktikën, i miratuar nga Gjykata. Këshilltarët juridikë mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve.

Sekretariati i ka realizuar këto objektiva të vitit 2015:

- Implementimi i Planit Strategjik 2014-2017;
- Hartimi dhe aprovimi i Rregullores për organizimin e brendshëm të GJKK-së, Nr. 01/2015;
- Hartimi dhe aprovimi i Rregullores për klasifikimin e vendeve të punës në GJKK-së, Nr. 02/2015;
- Ndryshimi dhe plotësimi i rregullores Nr. 03/2015 për avancimin dhe për transferimin e stafit të GJKK-së;
- Ndryshimi dhe plotësimi i rregullores Nr. 04/2015 për procedurat e rekrutimit, të emërimit dhe të punës provuese të stafit të GJKK-së;
- Ndryshimi dhe plotësimi i rregullores Nr. 05/2015 për organizimin e brendshëm të GJKK-së;
- Ndryshimi dhe plotësimi i rregullores Nr. 06/2015 për klasifikimin e vendeve të punës në GJKK.

Sekretariati gjithashtu publikoi:

- Raportin vjetor për vitin 2014;
- Raportin e tremujorit të katërt, tetor-dhjetor 2014;
- Raportin e tremujorit të parë, janar-mars 2015;
- Raportin e tremujorit të dytë, prill-qershor 2015;
- Raportin e tremujorit të tretë, korrik-shtator 2015;
- Buletinin e vendimeve 2014, në tri gjuhë.


**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE
NJERËZORE (DABNJ)**

I. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE (DABNJ)

I. Burimet njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve


- Në vitin 2015, në bazë të planit operacional të rekrutimit, janë përgatitur dhe janë publikuar 2 (dy) konkurse publike, të cilat kanë përfshirë 1 (një) vend pune për pozitën e Këshilltarit Juridik (junior) dhe 12 pozita për praktikantë.
- Më 15 prill 2015, është zgjedhur gjyqtari Bekim Sejdiu si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe ka filluar punën në vitin 2015. Në datën 26 qershor 2015, kanë përfunduar mandatin ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani dhe gjyqtari Kadri Kryeziu.
- Më 21 maj 2015, gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi u zgjodh si Kryetare e Gjykatës Kushtetuese dhe filloi mandatin e saj më 27 qershor të vitit 2015. Në shtator të vitit 2015, gjyqtari Ivan Čukalović u rizgjodh dhe iu vazhdua mandati i zëvendëskryetarit të Gjykatës edhe për tre vjet.
- Më 1 korrik 2015, ish-Kryetari i Gjykatës, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 04/L-038 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për Përfitim të Ish Zyrtarëve të Lartë dhe pas aprovimit edhe nga ana e Ministrisë së Financave, ka emëruar 3 (tre) punonjës për nevojat të mbështetjes së tij, të cilët edhe janë përfshirë në listën e pagave të Gjykatës Kushtetuese.
- Më 30 dhjetor 2015, Presidentja e Republikës emëroi Selvete Gerxhaliun- Krasniqin dhe Gresa Cakën – Nimanin si gjyqtare të reja të Gjykatës Kushtetuese.
- 61 pozitat e lejuara me buxhetin e vitit 2015 janë plotësuar. Në këtë numër nuk përfshihen 3 (tre) punonjës të emëruar nga ish Kryetari i Gjykatës Kushtetuese.
- Gjithsej, në listën e pagave për vitin 2015 kanë qenë të përfshira 63 pozita, ndërsa duke filluar nga 29 dhjetori 2015 është kërkuar që në listën e pagave të përfshihen edhe 2 (dy) gjyqtaret e reja.
- Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve prej 65 vetash, 35 janë të gjinisë mashkullore, apo 56%, ndërsa 30 të gjinisë femërore, gjegjësisht 44%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale 56 janë shqiptarë (83%), 5 serbë (10%), 2 turq (3%), 1 boshnjak (2%) dhe 1 malazias (2%).

Numri i të punësuarve sipas përkatësisë nacionale:



- Kanë përfunduar vlerësimet e kryerjes së punëve, për stafin administrativ të Gjykatës;
- Pozita e Shefit të Kabinetit të Kryetarit të Gjykatës është përshtatur dhe është emëruar një zyrtar i ri, ndërsa ish-shefi i Kabinetit është transferuar në Departamentin e Përkrahjes Profesionale, në pozitën e Menaxherit të përkthimeve.

Numri i të punësuarve sipas gjinisë:



II. Ngritja e kapaciteteve

Është zbatuar Programi kornizë i trajnimeve për nëpunësit e Gjykatës Kushtetuese, me qëllim të ngritjes së mëtejme të kapaciteteve dhe të aftësive vepruese, si dhe të zbatimit të politikave të aftësimit të stafit në kuadër të Gjykatës Kushtetuese.

Janë mbajtur punëtori jashtë vendit (3), punëtori brenda vendit (3), trajnime brenda vendit (35), trajnime jashtë vendit (1), vizita studimore jashtë vendit (4), konferenca rajonale jashtë vendit (1), tryeza të përbashkëta jashtë vendit (2), tryeza të rrumbullakëta brenda vendit (1), seminare brenda vendit (2), simpoziume jashtë vendit (5) dhe kurse të gjuhëve të huaja (2).


- 20 punonjës të Gjykatës kanë marrë pjesë në punëtorinë e parë, të mbajtur në Durrës, me temën “Shqyrtimi i projekt rregulloreve të reja dhe i Planit të Veprimit 2014-2017”;
- 16 punonjës të Gjykatës kanë marrë pjesë në punëtorinë e dytë, të mbajtur në Durrës, me temën “Raportimi i progresit për periudhën janar-shtator 2015 dhe planifikimi i aktiviteteve për periudhën tetor- dhjetor 2015 në zbatimin e Planit Strategjik”;
- 24 punonjës të Gjykatës kanë marrë pjesë në punëtorinë e mbajtur në Budvë të Malit të Zi, me temën: “Referrals to the Constitutional Court by the Supreme Court and other Regular Courts of the Republic of Kosovo” dhe “How to increase the sensibility of the Supreme Court and other Regular Courts to file Referrals with the Constitutional Court”;
- Një punëtori e organizuar nga GIZ-i është mbajtur në Gjykatë, me temën, “Projekti i reformës ligjore dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës”, me 4 punonjës të Gjykatës; Punëtorja e dytë është organizuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me temën “Mbi projektaktin nënligjor për mbrojtjen e të

dhënave”, ku ka marrë pjesë një punonjës nga Gjykata; Punëtorja e tretë brenda vendit është mbajtur Hotel Sirius, Prishtinë, me temën “Disciplinary Measures and Proceedings for Judges and Legal Advisers”, organizuar nga GJKK-ja dhe GIZ-i, me 19 pjesëmarrës;

- Janë mbajtur gjithsej 34 seanca trajnimesh brenda vendit: 13 prej tyre janë mbajtur ne Ministrinë e Financave për versionin e ri të SIMFK, FreeBallance V 7.0, me nga 13 pjesëmarrës; 21 trajnime nga fusha e jurisprudencës, fusha administrative, menaxheriale dhe ajo e teknologjisë informative, ku kanë marrë pjesë gjithsej 68 zyrtarë nga Gjykata;
- 2 punonjës të Gjykatës kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga IKM-ja me temë “Hartimi i raporteve, administrimi i zyrës dhe i operacioneve (aktiviteteve operative)”;
- 6 punonjës të Gjykatës kanë marrë pjesë në vizitën studimore në Gjykatën Kushtetuese Federale në Karlsruhe të Gjermanisë, e cila është organizuar nga IRZ-ja;
- Vizita tjetër studimore është zhvilluar në Këshillin Shtetëror të Francës (Conseil d’Etat), e cila është organizuar nga GIZ-i, ku ka marrë pjesë një punonjës i Gjykatës;
- 19 punonjës të Gjykatës kanë marrë pjesë në një vizitë studimore në Këshillin e Evropës dhe në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Strasburg;
- Dy këshilltarë ligjorë të Gjykatës kanë përfunduar vizitën studimore 5-mujore në Gjykatën e Strasburgut, me qëllim të përvetësimit sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës;
- 2 punonjës të Gjykatës kanë marrë pjesë në konferencën rajonale, me temën “Përdorimi efektiv i mjeteve vendase në procedurat ligjore të brendshme dhe roli subsidiar i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, mbajtur në Zagreb të Kroacisë;
- 7 punonjës të Gjykatës kanë marrë pjesë në një tryezë të përbashkët të gjykatave kushtetuese të Malit të Zi, Maqedonisë dhe Kosovës, me temë: “Veçoritë e procesit vendimmarrës para Gjykatës Kushtetuese”, organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me fondacionin Hans Seidel, mbajtur në Lezhë;
- 21 punonjës të Gjykatës kanë marrë pjesë në një tryezë të përbashkët, të mbajtur në Shkup të Maqedonisë, ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, me temën: “Aspekte të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative të Gjykatës Kushtetuese – Paraqitje e elementëve dallues dhe të përbashkët midis Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”;
- 1 (një) punonjës i Gjykatës ka marrë pjesë në një tryezë të rrumbullakët me temën “Mbi projektaktin nënligjor për sigurinë e të dhënave”, të organizuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (mbështetur nga projekti i BE-së);
- 12 punonjës të Gjykatës kanë marrë pjesë në seminarin me temë “Për të drejtën për gjykim në kohë të arsyeshme dhe të drejtën për mjete efektive në lidhje me tejzgjatjen e procedurës në bazë të KEDNJ-së”, të organizuar nga Projekti i Këshillit të Evropës dhe të mbajtur në Prishtinë;

- 1 (një) punonjës i Gjykatës ka marrë pjesë në seminarin e organizuar nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me temë “Roli dhe përgjegjësia e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili është mbajtur në Prishtinë;
- 5 punonjës të Gjykatës kanë marrë pjesë në një simpozium të organizuar në Turqi me rastin e përvjetorit të 53-të të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë;
- 15 punonjës të Gjykatës janë duke marrë pjesë në kurse të gjuhës angleze dhe franceze, të cilat zhvillohen në ambientet e Gjykatës në tremujorin e parë, duke rifilluar me atë të gjuhës frënge, në nëntor të vitit 2015. Kursi i gjuhës frënge është financuar nga Ambasada e Francës në Kosovë.

Numri i punonjësve që kanë marrë pjesë në punëtori, konferenca, trajnime dhe kurse, brenda dhe jashtë vendit:



III. Mbështetja administrative dhe logjistike

- Janë ofruar dhe janë siguruar shërbimet e kërkuara në logjistikë, transport dhe kontroll të hyrje-daljes së materialit shpenzues dhe të pajisjeve të TI-së si dhe është bërë regjistrimi i tij në Sistemin e Menaxhimit të Informatave të E-pasurisë;
- Është kryer regjistrimi i 290 faturave në Sistemin Free Balance, pas furnizimit me material shpenzues dhe me pajisje të TI-së, si dhe shërbimeve për nevoja pune të GJKK-së;
- Është bërë mirëmbajtja dhe servisimi i veturave të Gjykatës, si dhe janë përpiluar me kohë raportet mujore për shpenzimin e derivateve, përfshirë edhe Raportin vjetor për vitin 2015;
- Janë përpiluar dhe janë adresuar shkresat përkatëse drejtuar institucioneve të ndryshme lidhur me ekzekutimin e kërkesave të ndryshme administrative, të pagave dhe të mëditjeve;

- Janë ndërmarrë aktivitete shtesë dhe është monitoruar procesi i zbatimit të Planit Strategjik 2014-2017.

Në sferën e shërbimeve të bibliotekës

Në vitin 2015, në bibliotekën e Gjykatës Kushtetuese, janë pranuar dhe regjistruar këto libra:

- 22 libra janë pranuar nga GIZ-i; 2 ekzemplarë të komentarit mbi “Ligjin për Procedurën Administrative; komentari për “Kodin Penal të Republikës së Kosovës”; “Ligjet e aplikueshme në Kosovë nga fusha civile, penale, administrative dhe ekonomike dhe pjesë të ekzemplarit të ligjeve kryesore të aplikueshme në Kosovë”; komentaret: Ligji mbi Kodin për Procedurën Penale; Ustav Republike Kosovo - I izdanje; Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Law on the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, nga GIZ-i;
- 83 libra, revista dhe fletushka të ndryshme janë dorëzuar nga ish-kryetari, Enver Hasani;
- 5 libra janë dhuruar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë; 4 libra janë dhuruar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë; 1 libër është dhuruar nga Gjykata e Lartë e Shqipërisë; 1 kopje e librit “Priručnik za pripremanje pravosudnog ispita” është dhuruar nga Ministria e Drejtësisë; 3 kopje të librit “Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës”, po ashtu, janë dhuruar nga Ministria e Drejtësisë; 1 libër i lëmit juridik, në gjuhën angleze, është dhuruar nga gjyqtari Bekim Sejdiu; 1 libër juridik, dhuruar nga Këshilli i Evropës; 1 libër juridik, dhuruar nga kryetarja Arta Rama-Hajrizi; 1 libër nga fusha juridike, është blerë nga ana e Gjykatës Kushtetuese; 1 doracak për përkthyesit dhe interpretët, dhuruar nga OSCE; 1 libër juridik, dhuruar nga Këshilli Shtetëror francez; 3 libra juridikë në gjuhën shqipe, 3 libra juridikë në gjuhën serbe, 4 libra juridikë në gjuhën angleze, dhuruar nga donatorë të ndryshëm;
- 3 buletine nga Komisioni i Venecias, me nga dy kopje, botimi 2014/3;
- Aktet nënligjore të Gjykatës Kushtetuese dhe Udhëzimet Administrative 2-010/2012/2014, në të tri gjuhët; Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me amendamentet I-XXIII dhe rregullore të tjera të brendshme, botuar nga Gjykata Kushtetuese;
- Raport vjetor për vitin 2014 nga Organi Shqyrtues i Prokurimi, 1 copë; 3 raporte vjetore në tre gjuhë nga Agjencia Kosovare e Pronës;
- Revistë Juridike nr. 1, 2, 3 - 2014, 3 copë; revista “Shenja”, 2 copë; 1. revista “Autori”, shtator 2015, nga zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta të Përafërta, botim i MKRS-së; 1 revistë “ICL-Journal”; 2 kopje të revistës “Fly-Inn”, nr. 5, korrik 2015, dhe 1 me nr. 7 dhjetor 2015, botim i Aeroportit të Prishtinës;
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 1, 2, 3, 4, të muajit janar 2015, me nr. 5, të muajit shkurt, me nr. 6, të muajit mars, me nr. 7, 8, 9, të muajit prill, me nr. 10, 11, të muajit maj, me nr. 12, 13, 14, 15, të muajit qershor, me nr. 18, 19, 20, 21, 22, të muajit korrik 2015, me nr. 23, 24, 25, 26, 27, të muajit gusht 2015, me nr. 28, 29, 30, 31, të muajit shtator 2015, me nr. 32, 33, të muajit nëntor 2015, dhe me nr. 34, të muajit dhjetor 2015, me nga 3 copë nga Zyra për publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Aktivitete të tjera

Në zbatim të Vendimit të Gjykatës, Nr. ref.: KK-S48202/15, të 16 tetorit 2015, në lidhje me aprovimin e pozitës Menaxher për koordinimin e përkthimeve dhe ridefinimit të statusit të pozitës së Shefit të Kabinetit, janë propozuar ndryshimet përkatëse në aktet nënligjore të Gjykatës:

- Rregullore nr. 03/2013 për avancimin dhe për transferimin e stafit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 13;
- Rregullore nr. 02/2013 për procedurat e rekrutimit, të emërimit dhe të punës provuese të stafit në Gjykatën Kushtetuese; neni 52;
- Rregullore nr. 01/2014 për organizimin e brendshëm të Gjykatës Kushtetuese, nenet 13, 22, 23 dhe 26;
- Rregullore nr. 02/2014 për klasifikimin e vendeve të punës në Gjykatën Kushtetuese, nenet 6 dhe 10;
- Katalogu i përshkrimit të detyrave të punës;
- Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën e Shefit të Kabinetit të Kryetarit.

Përfundimet:

Edhe përkundrejt përkufizimeve dhe sfidave të hasura, është arritur të ofrohen me kohë shërbimet e domosdoshme për funksionimin e Gjykatës, në çështjet që varen nga mandati i DABNJ-së.

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE
(DPP)

II. DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE (DPP)

Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP) është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të përkthimit, të redaktimit, të lekturës, të transkriptimit dhe të harmonizimit të terminologjisë në të gjitha dokumentet e Gjykatës Kushtetuese në gjuhët në të cilat punon GJKK-ja.

DPP-ja ka organizuar, ka udhëhequr dhe ka mbikëqyrur punën e përkthimit (në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze e për ueb-faqen zyrtare të Gjykatës edhe në gjuhën turke), të redaktimit e të lekturës (në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe), të transkriptimit dhe të përkthimit aty për aty (simultan). Kështu, nëpër DPP kanë kaluar 18.169 faqe, ose mesatarisht 72 faqe në ditë, të shkresave, të dokumenteve të ndryshme, të aktgjykimeve, të aktvendimeve, të vendimeve për hedhje poshtë të kërkesave me procedurë të shkurtuar, të raporteve paraprake e të tjera në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe, në gjuhën angleze dhe në gjuhën turke.

Interpretët kanë bërë 587 orë e 55 minuta përkthime simultane në takime të rregullta, në seanca të Gjykatës, në seanca administrative, në intervista të kandidatëve për pozitat e shpallura nga GJKK-ja, si dhe në takime të tjera.

Në bashkërenditje me DRLSA-në, DPP-ja ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për takimet e gjyqtarëve dhe për seancat shqyrtuese e administrative.

DPP-ja ka bërë procedimin e lëndëve në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze. Njëkohësisht, ka kontribuar në publikimin e vendimeve në shqip, në serbisht, në anglisht dhe në turqisht.

Objektivat

Objektivat që ka arritur DPP-ja janë këto:

- Standardizimi i të gjitha dokumenteve zyrtare dhe i të gjitha vendimeve që mbajnë vulën e Gjykatës Kushtetuese;
- Eliminimi i mospërputhjeve në aktgjykime, në aktvendime, në raporte paraprake e në dokumente të tjera të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës;
- Përditësimi i fjalorit të veçantë terminologjik tre gjuhësh të shprehjeve të Gjykatës Kushtetuese;
- Nxitja në përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për të vënë në praktikë menaxhimin dhe planifikimin me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe për të ngritur bashkëpunimin ndërmjet departamenteve;
- Bashkëpunimi me operatorin, sa i përket përkthimit (jashtë Gjykatës dhe në Gjykatë); dhe
- Jetësimi me sukses i të gjitha objektivave që dolën për vitin 2015 nga Plani strategjik i GJKK-së 2014-2017.

**DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE,
STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA)**

III. DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA)

1. Statusi i lëndëve


Gjatë vitit 2015, Gjykata ka pasur në punë gjithsej 227 kërkesa/lëndë:

- 63 kërkesa janë bartur nga viti 2014, prej të cilave 59 janë zgjidhur;
- 164 kërkesa janë pranuar në vitin 2015, prej të cilave 67 janë zgjidhur.

Gjithsej 126 kërkesa janë zgjidhur, ose 55.5% e të gjitha rasteve në dispozicion (227).

Në vitin 2015, 143 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe janë proceduar te palët, ndërsa 16 kërkesa të zgjidhura janë në proces të përgatitjes.

Dinamika e kërkesave të pranura në vitin 2015



Në vitin 2015, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë 5 aktgjykime:

- Aktgjykim në kërkesën KO130/15, e parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj, Atifete Jahjaga. Kjo kërkesë ka të bëjë me përputhshmërinë e parimeve që përmban dokumenti i titulluar “Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme /Elementet kryesore” me frymën e Kushtetutës, me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit], me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

- Aktgjykim në kërkesat KI144/14 dhe KI156/14, të parashtruara nga Vilijamin Hajduković-i dhe Stanka Tus-i, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të dy vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, përkatësisht Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007, dhe Vendimit HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006;
- Aktgjykim në kërkesën KO26/15, të parashtruar më 9 mars të vitit 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës për të konfirmuar se amendamenti i Kushtetutës të Republikës së Kosovës, i propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i redukton të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës;
- Aktgjykim në kërkesën KO13/15, të parashtruar më 6 shkurt të vitit 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës për të konfirmuar se amendamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i propozuar nga pesëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk i pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës;
- Aktgjykim në kërkesën KI72/14, parashtruar nga Besa Qirezi, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 712/2013, të 21 tetorit 2013;

2. Parashtrimi i kërkesave

Gjykata Kushtetuese vendos për çështje të cilat i referohen në rrugë ligjore nga palë të autorizuar.

Në vitin 2015, në Gjykatën Kushtetuese janë parashtruar 164 kërkesa, që do të thotë se janë pranuar mesatarisht 13.7 kërkesa në muaj.

- 152 kërkesa individuale, ose 92,7% (nga persona fizikë);
- 12 kërkesa nga autoritete të tjera publike ose 7,3% (nga persona juridikë).

3. Shpërndarja e kërkesave

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, DRLSA-ja i ka proceduar të gjitha kërkesat e parashtruara sipas nenit 13 të Kushtetutës.

Shpërndarja e kërkesave/lëndëve për gjyqtarët raportues është bërë në përputhje me rregullat 8 dhe 34 të Rregullores së punës të Gjykatës. Përjashtim nga ky rregull përbën shpërndarja e kërkesave për vënien e Masës së përkohshme, të cilat kërkesa procedohen sipas rregullit 55 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, dhe rasteve *ad hoc*, të cilat paraqesin konflikt interesi, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Gjykatën dhe në pajtim me rregullin 7 të Rregullores së punës.


4. Qasja në Gjykatë dhe besimi i publikut në punën e Gjykatës

Të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike, kanë qasje të barabartë në Gjykatën Kushtetuese.

- 131 kërkesa, ose 79,9% janë parashtruar nga shqiptarët;
- 21 kërkesa ose 12,8% janë parashtruar nga serbët;

- 12 kërkesa ose 7,3% janë parashtruar nga autoritete të tjera publike (persona juridikë).

STRUKTURA ETNIKE E PARAQITËSVE TË KËRKESAVE




5. Shkeljet e supozuara

Lënda e 164 kërkesave ka të bëjë me shkelje të këtyre neneve:

- Neni 21 [Parimet e Përgjithshme], 3 raste ose 1.8%;
- Neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 3 raste ose 1.8%;
- Neni 24 [Barazia para Ligjit], 33 raste ose 20,1 %;
- Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 2 raste ose 1.2%;
- Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 63 raste ose 38.4%;
- Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 1 rast ose 0.6%;
- Neni 46 [Mbrojtja e Pronës], 35 raste ose 21.3%;
- Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 11 raste ose 6.7%;
- Neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], 1 rast ose 0.6%;
- Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 3 raste ose 1.8%;
- Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të autoriteteve të tjera publike, 4 raste ose 2.4%; dhe
- Shkelje të tjera, 5 raste ose 3,0%.


SHKELJET E SUPOZUARA



6. Shkeljet e pretenduara të të drejtave

- 155 kërkesa ose 94,5% kanë të bëjnë me shkelje që pretendohen të jenë kryer me anë të vendimeve të gjykatave; dhe
- 9 kërkesa ose 5,5% kanë të bëjnë me shkelje që pretendohen të jenë bërë nga autoritete të tjera publike.

SHKELËSIT E SUPOZUAR TË TË DREJTAVE




7. Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë vitit 2015, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 32 seanca plenare dhe 122 kolegje shqyrtuese, në të cilat rastet e shqyrtuara u zgjidhën me:

- 5 aktgjykime;
- 92 aktvendime për papranueshmëri;
- 13 aktvendime për papranueshmëri dhe refuzim i Masës së përkohshme;
- 2 vendime për masë të përkohshme;
- 6 vendime për refuzim të kërkesës; dhe
- 4 vendime për hedhje poshtë të kërkesës.

STRUKTURA E VENDIMEVE NË NUMËR DHE PËRQINDJE



**DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCIVE
(DBF)**

IV. DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE (DBF)

Departamenti i Buxhetit dhe Financave

Mjetet e ndara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për Gjykatën Kushtetuese, të aprovuara për vitin 2015 janë 1,470,170.00€, ndërsa me rishikimin e buxhetit në vitin fiskal 2015 janë 1,459,829.00€. Ndryshimi i buxhetit me rishikim është 10,341.00€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe janë shtuar 3 pozita si zyrtar të ish – Kryetarit të GJKK-së. Ndryshimi i buxhetit ka ndodhur me transfer të brendshëm nga Shpenzimet Komunale në Mallra dhe Shërbime në shumë prej 1,120.00€. Me vendimet e Qeverisë 12/64 si dhe 09/65 për kursime të mjeteve, GJKK-së në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ju kanë marrë 48,185.89€, në kategorinë e shpenzimeve komunale 2,284.60€, si dhe në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 214.07€. Buxheti final në SIMFK për vitin fiskal 2015 është 1,409,144.44€, si dhe donacione të mbetura nga vitet e mëhershme në shumë prej 27,747.25€ dhe sipas strukturës përkatësisht kategorive ekonomike, pasqyrohen në paraqitjet tabelore.

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
965,864.00€	487,585.00€	6,380.00€	0.00€	0.00€	1,459,829.00€

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencione dhe transfere	Donacione	Gjithsej
917,678.11€	487,370.93€	4,095.40€	0.00€	0.00€	27,747.25	1,436,891.69€

Buxheti i aprovuar 2015, alokimi dhe realizimi për periudhën Janar – Dhjetor

	Buxheti i aprovuar 2015 (A) €	Alokimet janar- dhjetor (B) €	Realizimet janar-dhjetor (C) €	% (C/A) €	% (C/B) €
Paga dhe mëditje	965,864.00	917,678.11	917,678.11	95.01	100
Mallra dhe shërbime	487,585.00	487,370.93	485,328.26	99.55	99.59
Shpenzime komunale	6,380.00	4,095.40	3,118.15	48.87	76.13
Subvencione dhe transfere	0,00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,459,829.00	1,409,144.44	1,406,124.52	96.32	99.79

Alokimet e mjeteve nga buxheti i Kosovës sipas rrjedhjes së parasë për periudhën Janar – Dhjetor

Në buxhetin e përgjithshëm pjesëmarrja e alokimit në vitin fiskal 2015 ka qenë 1,409,144.44€, e shprehur në përqindje 100%.

	Janar-Shtator €	Tetor €	Nëntor €	Dhjetor €	Gjithsej €	%
Paga dhe mëditje	692,925.63	75,296.99	74,194.49	75,261.00	917,678.11	100
Mallra dhe shërbime	413,806.00	37,000.00	19,477.00	17,087.93	487,370.93	100
Shpenzime komunale	5,800.00	580.00	0.00	-2,284.60	4,095.40	100
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,112,531.63	112,876.99	93,671.49	90,064.33	1,409,144.44	100

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit në vitin fiskal 2015 ka qenë 1,406,214.52€ e shprehur në përqindje 99.79%.

Realizimi i buxhetit:

	Alokimet janar – dhjetor (A) €	Realizimi janar – dhjetor (B) €	Mbetja e mjeteve (C) €	% (B/A) €
Paga dhe mëditje	917,678.11	917,678.11	0.00	100
Mallra dhe shërbime	487,370.93	485,328.26	2,042.67	99.59
Shpenzime komunale	4,095.40	3,118.15	977.25	76.13
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,409,144.44	1,406,124.52	3,019.92	99.79

Realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje

Realizimi i pagave dhe mëditjeve sipas muajve:

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Realizimi	Mbetja
Janar	59	73,972.00	72,348.20	1,623.80
Shkurt	59	74,830.00	73,513.05	1,316.95
Mars	59	74,830.00	74,611.20	218.80
Prill	61	76,330.00	76,321.04	8.96
Maj	61	77,830.00	77,619.27	210.73
Qershor	61	78,499.72	81,878.96	-3,379.24
Korrik	61	81,883.62	81,883.62	0.00
Gusht	63	85,537.73	78,482.14	7,055.59
Shtator	63	69,212.56	76,268.15	-7,055.59
Tetor	62	75,296.99	75,296.99	0.00
Nëntor	62	74,194.49	74,194.49	0.00
Dhjetor	63	75,261.00	75,261.00	0.00
Gjithsej		917,678.11	917,678.11	0.00

Realizimi i buxhetit për mallra dhe shërbime

Realizimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2015 sipas muajve:

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	72,000.00	72,000.00	60,162.76	11,837.24
Shkurt	52,000.00	52,000.00	43,449.77	8,550.23
Mars	48,000.00	48,000.00	28,975.31	19,024.69
Prill	42,000.00	42,000.00	56,639.35	-14,639.35
Maj	52,000.00	52,000.00	50,340.79	1,659.21
Qershor	40,000.00	40,000.00	39,364.59	635.41
Korrik	50,000.00	50,000.00	43,010.66	6,989.34
Gusht	22,806.00	22,806.00	10,871.53	11,934.47
Shtator	35,000.00	35,000.00	50,290.66	-15,290.66
Tetor	37,000.00	37,000.00	40,586.91	-3,586.91
Nëntor	19,477.00	19,477.00	47,553.48	-28,076.48
Dhjetor	17,087.93	17,087.93	14,082.45	3,005.48
Gjithsej	487,370.93	487,370.93	485,328.26	2,042.67

Investime kapitale

Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin fiskal 2015 nuk i janë ndarë mjete financiare në kategorinë e investimeve kapitale.

Realizimi i buxhetit për shpenzime komunale

Realizimi i buxhetit në kategorinë e shpenzimeve komunale për vitin 2015:¹

Shpenzimet e komunaleve	Destinimi	Kodi ekonomik	Buxheti i aprovuar €	Alokimet janar – dhjetor	Realizimi €
	Shpenzimet e telefonisë fikse	13250	4,095.40	4,095.40	3,118.15

¹ Shpenzimet e komunalive nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, shpenzimet e rrymës dhe mbeturinave i mbulon Ministria e Administratës Publike.

NJËSIA E PROKURIMIT
(NJP)

V. NJËSIA E PROKURIMIT (NJP)

Në pajtim me kërkesat e nenit 8, pikës 2, të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, më 13 janar 2015 është dorëzuar Plan i final i prokurimit për vitin 2015 në Agjencinë Qendrore të Prokurimit Publik.

Në pajtim me kërkesat e nenit 8, pikës 1, të LPP-së, më 30 tetor të vitit 2015, është dorëzuar Plan i përfundimtar i prokurimit për vitin 2016 dhe në pajtim me nenin 8, pika 2, të LPP-së, dhe më 13 janar 2016 është dorëzuar Plan i final i prokurimit për vitin 2016 në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP).

Në mbështetje të Planit final të viti 2015, janë iniciuar gjithsej 24 procedura të prokurimit, ndërsa 1 (një) është bartur nga viti 2014.

Procedurat e prokurimit i kemi klasifikuar sipas tipit, vlerës dhe procedurës në pajtim me LPP-së. Këto janë si më poshtë:

1. Procedura e hapur (vlerë e mesme) e bartur nga viti 2014

Aktivitet i bartur nga viti 2014 dhe kontratë e nënshkruar në vitin 2015, për projektin me titull: “Shërbime të mirëmbajtjes dhe pastrimit të hapësirave dhe objekteve të GJKK-së”.

2. Procedura e hapur (vlerë e mesme)

Janë iniciuar gjithsej 7 (shtatë) procedura me vlerë të mesme në vitin 2015, që kanë rezultuar në nënshkrimin e gjithsej 7 (shtatë) kontratave.

Kontrata të nënshkruara janë: “Shërbime të mësimi të gjuhës shqipe, angleze dhe serbe për nevoja të stafit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës”; “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Passat 2.0 TDI HIGHLINE (4 MOTION)”; “Furnizim me naftë dhe derivate të naftës për nevoja të GJKK-së”; “Furnizim me material reprezentativ me logo të GJKK-së”; “Furnizim me tonerë për nevoja të GJKK-së”; “Shërbime fotografimi, kornizimi dhe shërbime të xhirimit për nevoja të GJKK-së”; “Furnizimi, shtypja e broshurave dhe materialeve tjera për shtypje”.

3. Procedura e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël)

Janë iniciuar gjithsej 7 (shtatë) procedura me vlerë të vogël, që kanë rezultuar në nënshkrimin e gjithsej 6 (gjashtë) kontratave, ndërsa 1 (një) aktivitet është ndërprerë dhe është anuluar.

Kontratat e nënshkruara janë: “Furnizim me laptopë për nevoja të GJKK-së”; “Shërbime të botimit të materialeve për nevoja të GJKK-së”; “Realizimi i video-projektit për historikun e GJKK-së”; “Furnizim me gazeta ditore, javore edhe mujore”; “Shërbime të ofrimit të pajisjeve të zërimit për interpretim simultan”; “Sigurimi i automjeteve zyrtare TPL, TPL Plus dhe Kasko e plotë EU”. Është anuluar aktiviteti i prokurimit me titull: “Servisimi dhe mirëmbajtja e aklimatizimit dhe klimave ekzistuese si dhe mbushja e tyre me freon në objektin e GJKK-së”.

4. Procedura me vlerë minimale

10 (dhjetë) kanë qenë gjithsej procedurat me vlerë minimale, të cilat kanë rezultuar në nënshkrimin e gjithsej 10 (dhjetë) kontratave.

Kontratat e nënshkruara janë: “Dhurata për festën e 8 Marsit për zyrtarët e gjinisë femërore të GJKK-së”; “Furnizim me libra të ndryshme për nevoja të GJKK-së”; “Furnizim me libra specifike për Vitin gjyqësor”; “Shërbime teknike të riparimit, të mirëmbajtjes, të ngjyrosjes dhe politurë të 3 (tri) automjeteve: Passat 2.0 Highlane, Passat 2.0 R-Line dhe Peugeot 308”; “Servisimi dhe mbushja me gas e klimës MIDEA (MGA-D65/SN2) si dhe mbushja me gas e klimave ekzistuese sipas nevojave në objektin e GJKK-së”; “Furnizim me aparat mobil

(telefon) për nevoja të GJKK-së”; “Furnizim me gardërobë për vozitësit e GJKK-së”; “Furnizim me tepisonë–staza në hapësirat e objektit të GJKK-së”; “Suvenire me simbole për dhurata me logo të GjK-së”; “Furnizim me aparat mobil (telefon) për nevoja të sekretariatit të GjKK-së”.

Pasqyrimi në tabelë i të gjitha pagesave të realizuara gjatë vitit 2015, si dhe pagesat e kontratave afatgjate të nënshkruara nga Njësia e Prokurimit:

Klasifikimi i kontratave nëpër vite	Shuma e pagesave gjatë vitit 2015
a) Pagesa sipas kontratave afatgjate të nënshkruara në vitin 2015	63,792.28
b) Pagesa sipas kontratave afatgjate të nënshkruara në vitin 2014	176,375.79
c) Pagesa sipas kontratave afatgjate të nënshkruara në vitin 2013	54,218.20
d) Pagesa sipas kontratave afatgjate të nënshkruara në vitin 2012	41,862.45
Gjithsej (a+b+c+d)	336,248.72

NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MULTIMEDIAVE (NJTİKM)

VI. NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MULTIMEDIAVE (NJTIKM)

Njësia e Teknologjisë së Informacionit, Komunikimit dhe Multimedias, përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe për përkujdesjen profesionale në infrastrukturën e përgjithshme të teknologjisë informative në Gjykatë Kushtetuese.

Gjatë viti 2015, Njësia TIK dhe Multimedia ka realizuar projekte dhe detyra sipas planit dhe përgjegjësi të saj, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe profesional me pajisje të avancuara teknologjike, në përputhje me Planin Strategjik të Gjykatës Kushtetuese.

Projektet e realizuara nga NJTIKM

1. Avancimi i sistemit CDMS në ueb-aplikacion

- Projekti për avancimin e sistemit CDMS (Case Data Managment System – Sistemi për Menaxhimin e të Dhënave të Rasteve) është iniciuar me qëllim të avancimit të sistemit ekzistues nga aplikacioni Windows në ueb-aplikacion. Aplikacioni është instaluar dhe është testuar me sukses dhe janë mbajtur trajnime për përdoruesit e sistemit. Të gjitha të dhënat janë migruar me sukses. Pranimi final i aplikacionit, së bashku me kodin burimor të zhvillimit, është bërë më 5 qershor 2015 dhe nga kjo datë sistemi është në përdorim të plotë.
- Projekti është iniciuar dhe është propozuar nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa është mbështetur dhe është financuar nga organizata EROL-USAID.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Konfigurimi i politikave të reja për siguri të e-postës dhe për llogaritë e punonjësve të Gjykatës;
- Përmirësimi në ndryshimet e fundit të strukturës organizative dhe publikimi në ueb-faqe;
- Iniciimi i procesit dhe specifikimi teknik për blerjen e pajisjeve të TI-së sipas planit të paraparë;
- Formatimi i Raportit vjetor 2015 në tri gjuhët zyrtare dhe publikimi në ueb-faqen e Gjykatës;
- Formatimi dhe përgatitja për printim i raporteve tremujore dhe gjashtëmujore për vitin 2015 në tri gjuhët zyrtare;
- Krijimi i back-up dhe transferimi i tyre në serverët e dedikuar për Gjykatën në Data-Center të ASHI-së;
- Ndryshimet në ueb-faqen e Gjykatës sipas kërkesave të Sekretariatit;
- Instalimi i WSUS serverit për instalimin e përditësimeve (update) për të gjithë shfrytëzuesit në Gjykatë;
- Sipas kërkesave të stafit, ka filluar instalimit i MS Office 2013;
- Parashtrimi i kërkesës për inicim të procesit të prokurimit dhe për specifikimin teknik për ofrimin e pajisjeve të zërimit dhe interpretimit simultan;
- Përgatitja dhe instalimi i pajisjeve të teknologjisë për dy gjyqtaret e reja;
- Instalimi i softuerit Trados dhe vendosja e licencave në 7 kompjuterët e përkthyesve në DPP;
- Janë publikuar 143 vendime në ueb-faqe në tri gjuhë;
- Intervenime teknike në pajisjet e punonjësve sipas kërkesave;

- Përkujdesje dhe ofrim i shërbimeve për mbarëvajtjen e sistemeve dhe të pajisjeve të teknologjisë informative dhe të komunikimit;
- Përkujdesje në mbarëvajtjen e sistemit të interpretimit simultan dhe të incizimit të seancave dhe diskutimeve gjyqësore publike;
- Kontroll dhe mirëmbajtje e sistemit të domenit të Gjykatës dhe krijimi i politikave të sigurisë në serverë;
- Përkujdesje në krijimin e kopjeve (back-up) të domenit të Gjykatës dhe të sistemit CDMS;
- Pjesëmarrje në dy punëtori për Planin Strategjik të Gjykatës Kushtetuese;
- Pjesëmarrje në trajnimin “ISO 27001, Information Security Management Systems (ISMS) Implementation” Pjesëmarrja në konferencën e “Microsoft Industry Week”.

AUDITIMI

VII. AUDITIMI

1. Auditimi i brendshëm

Bazuar në planin vjetor për vitin 2015, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka përfunduar me kohë të gjitha auditimet e planifikuara, si:

- Menaxhimi i personelit;
- Menaxhimi i pasurisë;
- Menaxhimi i logjistikës;
- Menaxhimi i prokurimit;
- Menaxhimi i shpenzimeve;
- Plan i strategjik i auditimit të brendshëm për periudhën 2016-2018; dhe
- Plan vjetor i auditimit të brendshëm për vitin 2016.

Të gjitha auditimet e brendshme janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të institucionit dhe të NJAB-ës që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë, me shmangien e gabimeve të mundshme, me rritjen e vlerës dhe me raportimin e parregullsive dhe të gabimeve, me qëllim të shtimit të kontrollit që të ofrojë siguri të menaxhmenti për funksionim efikas në departamentet përkatëse.

Në vazhdimësi janë bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe të zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm.

Menaxhmenti ka vlerësuar punën e auditorëve dhe, në rastin e parë të mundshëm, është kujdesur për implementimin e rekomandimeve të dhëna si nga Auditori i Brendshëm, gjithashtu edhe nga auditorët e përgjithshëm. Ky implementim ka ndikuar në rritjen e cilësisë së aktiviteteve dhe performancës së institucionit.

NJAB-ja ka realizuar planin për vitin 2015 dhe ka realizuar vizitat përcjellëse për implementimin e rekomandimeve.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm - organ i pavarur këshillëdhënës - në Gjykatën Kushtetuese, funksionon bazuar në:

- Udhëzimin Administrativ nr. 11-2010 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektet e Sektorit Publik;
- Statutin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm (KAB);
- Praktikën e mira; dhe
- Standardet ndërkombëtare të auditimit.

Gjatë vitit 2015, KAB-i ka zhvilluar 5 takime dhe ka siguruar mbikëqyrje të planeve, të raporteve dhe implementimin e rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

Për vitin 2015, Komiteti i Auditimit ka konkluduar se Gjykata Kushtetuese funksionon në nivel të kënaqshëm, ka vlerësuar bashkëpunimin menaxhment-NjAB, ku me kohë adresohen dhe implementohen rekomandimet si nga Auditori i Përgjithshëm, po ashtu edhe nga Auditori i Brendshëm.

3. Auditimi i Jashtëm

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer fazën e përkohshme të auditimit në muajin nëntor 2015 për pasqyrat financiare të vitit 2015. Gjykata ka pranuar Memon e auditimit, ku konstatohet: “ZAP nuk ka identifikuar ndonjë çështje të rëndësishme për adresimin e rekomandimeve si dhe ekzekutimin e buxhetit 72%. Menaxhmenti ka dëshmuar kontrolle të mira dhe ka filluar me procesin e menaxhimit të rreziqeve në përputhje me objektivat e saj, duke hartuar matricën e rreziqeve”. Gjykata Kushtetuese, për këtë fazë të auditimit, nuk ka pranuar asnjë këshillë për menaxhmentin.

NJËSIA LIGJORE
(NJL)

VIII. NJËSIA LIGJORE (NJL)

Gjykata Kushtetuese punëson një numër të juristëve në nivele të ndryshme, të cilët përkrahin punën profesionale të gjyqtarëve dhe të administratës së Gjykatës. Asistenca për gjyqtarët ka të bëjë kryesisht me këshillime në çështjet e ngritura para Gjykatës, që kanë të bëjnë me raste të natyrave të ndryshme. Këshilltarët ligjorë ndihmojnë veçanërisht në hartimin e korrespondencës, përgatitjen e raporteve dhe vendimeve për Gjykatë dhe kujdesen po ashtu për procedurat tjera deri sa vendimet e Gjykatës të marrin formën përfundimtare.

Këshilltarët juridikë që punojnë në Gjykatë nuk janë shërbyes civilë, por kanë statusin e të punësuarit profesionist me kohë të pacaktuar në Gjykatë, me kushte të punës specifike dhe të përcaktuara me Rregullore të punës e me Udhëzimin praktik për Njësine Ligjore. Sa i përket këshillimeve që ofrojnë ata janë të pavarur.

Njësia ligjore përbëhet nga nëntë (9) këshilltarë juridikë senior, tre (3) janë junior nga dhe një (1) sekretar juridik. Dy këshilltarët e tanishëm juridikë senior janë ndërkombëtarë, ndërsa pjesa tjetër e tyre janë vendor dhe i përkasin etnive të ndryshme.

Njësia ligjore menaxhohet nga Këshilltari kryesor juridik dhe 2 zëvendëskëshilltarë. Këshilltari kryesor juridik vepron në kapacitet ndërlidhës ndërmjet Kryetarit të Gjykatës dhe Sekretarit të Përgjithshëm, që menaxhon dhe koordinon punën e Njesisë Ligjore.

Njësia ligjore mban takime të rregullta një herë në javë për të diskutuar çështje të ndryshme kushtetuese, për të përcjellë gjendjen e rasteve, për të rishikuar mundësitë e akteve të brendshme të Gjykatës si dhe konsultime rreth praktikës gjyqësore.

Për më tepër, që nga themelimi i saj e deri më sot, Njësia ligjore vazhdon të mbajë një bazë të dhënash, ku të gjitha rastet janë të rregulluara në bazë të llojit të vendimit, natyrës së kontesteve, natyrës së shkeljeve të konstatuara, etj. Kjo bazë e të dhënave menaxhohet nga një grup i këshilltarëve juridikë. Detyra kryesore e këtij grupi është që të sigurojë raporte hulumtuese për të ndihmuar gjyqtarët dhe këshilltarët juridikë në punën e tyre në rastet e pazgjidhura.

Sa i përket përcjelljes së gjendjes së rasteve, Njësia ligjore mban një raport të rasteve që e përshkruan rastin, nga momenti kur i caktohet këshilltarit juridik deri në publikimin e tij në uebfaqen e Gjykatës.

Faktor i rëndësishëm në sigurimin e vendimmarrjes efikase juridike dhe ngritjes së hartimit të raporteve dhe vendimeve është trajnimi i profesionistëve të Gjykatës në fusha të ndryshme të punës. Në kuadër të aktiviteteve të Gjykatës, anëtarët e Njesisë ligjore marrin pjesë në punëtori gjatë tërë vitit. Lista e plotë e aktiviteteve mund të gjendet në Pjesën VII të këtij Raporti (Aktivitetet e Gjykatës).

Përveç kësaj, Gjykata në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Ambasadën e Zvicrës, vazhdon me mbështetjen e projektit trajnues për këshilltarët e saj juridikë, që konsiston në dërgimin e dy këshilltarëve juridikë çdo 5 (pesë) muaj trajnim në Sekretariatit e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Qëllimi i këtij projekti është ndërtimi i kapaciteteve të këshilltarëve juridikë përmes ngritjes së aftësive të hartimit dhe të njohurive.

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM
(ZKI)

IX. ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKI)

Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI) është njësi e re në kuadër të strukturës organizative të Gjykatës Kushtetuese. Kjo zyrë është themeluar në përputhshmëri me objektivat e Planit Strategjik të Gjykatës në fillim të vitit 2015. Në fushën e përgjegjësive të saj bëjnë pjesë informimi dhe komunikimi me mediet/publikun, komunikimi me palët/qytetarët, protokoli, qasja në dokumentet zyrtare të Gjykatës, si dhe bashkëpunimi me Komisionin e Venecias.

Gjatë vitit 2015, në Zyrën për Komunikim dhe Informim janë kryer këto veprimtari:

I. Komunikimi me mediet/publikun:

- Janë përpiluar 52 raporte javore të medieve;
- Është botuar Raporti vjetor i medieve për vitin 2014;
- Është bërë arkivimi fizik dhe elektronik i raporteve të medieve të shtypura (626 artikuj) dhe atyre elektronike (797 artikuj) për punën e Gjykatës;
- Janë publikuar 42 njoftime për medie;
- Janë publikuar 80 njoftime të brendshme përkitazi me punën dhe aktivitetet e Gjykatës;
- Janë parashtruar 137 pyetje nga mediet e shkruara dhe ato elektronike, si dhe 14 pyetje/kërkesa nga qytetarët.

II. Bashkëpunimi me Komisionin e Venecias:

- Janë dërguar përgjigjet e Gjykatës në 93 pyetje të parashtruara nëpërmjet Forumit të Komisionit të Venecias nga 13 gjykata kushtetuese dhe gjykata supreme të shteteve anëtare, si dhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Janë dorëzuar 3 raporte katër mujore, së bashku me vendimet më të rëndësishme të Gjykatës gjatë kësaj periudhe, për publikim në Buletinet e Komisionit të Venecias.

III. Aktivitetet protokollare:

- Janë kryer të gjitha detyrat protokollare përkitazi me 13 vizita zyrtare në Gjykatë, 12 vizita zyrtare jashtë vendit, 8 punëtori/konferenca në Kosovë dhe 4 punëtori/konferenca jashtë vendit.

IV. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare:

- Është përpiluar dhe është dorëzuar Raporti vjetor për kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës gjatë vitit 2015;
- Gjatë vitit 2015 janë pranuar gjithsej 7 kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës, prej të cilave 6 kërkesa janë pranuar ndërsa 1 kërkesë është lejuar pjesërisht.

V. Komunikimi me palët/qytetarët:

- Gjatë vitit 2015, në recepsionin e Gjykatës janë regjistruar dhe shërbyer:
 - 557 qytetarë;
 - 123 përfaqësues institucionesh; dhe
 - 30 përfaqësues mediesh.

AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE

X. AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE

I. Udhëtimet zyrtare

12 - 13 mars 2015

Kryetari Hasani, me ftesë të Këshillit të Evropës, mori pjesë në Konferencën rajonale me temë: *“Përdorimi efektiv i mjeteve vendase në procedurat ligjore të brendshme dhe roli subsidiar i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, në Zagreb.

Konferenca u organizua nga Drejtoria e përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit të Këshillit të Evropës, në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit, në të cilën morën pjesë përfaqësues të Këshillit të Evropës, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, akademikë, gjyqtarë, avokatë dhe hulumtues shkencorë nga të gjitha vendet e rajonit.

20 - 21 mars 2015

Kryetari Hasani, dhe gjyqtarja, Mr. sc. Arta Rama – Hajrizi, morën pjesë në Sesionin e 102-të Plenar të Komisionit të Venecias, në Venecie të Italisë.

Sesioni i 102-të Plenar i Komisionit të Venecias është mbajtur më 20 dhe 21 mars 2015, në të cilin kryetari Hasani mori pjesë në cilësinë e anëtarit përfaqësues të Republikës së Kosovës, ndërkaq gjyqtarja Rama-Hajrizi si zëvendës-anëtare.

Kryetari Hasani mori pjesë si panelist edhe në punimet e tri nënkomisioneve të Komisionit të Venecias: për gjyqësorin, për institucionet demokratike, si dhe për të drejtat themelore.

22 - 24 mars 2015

Kryetari Hasani mori pjesë në Simpoziumin e 9-të të Unionit të Gjykatave dhe të Këshillave Kushtetuese Arabe me temë: *“Roli i gjyqësorit kushtetues në zhvillimin e sistemeve kushtetuese dhe politike – përvojat arabe”*, i mbajtur në Kuvajt.

I ftuar në cilësinë e përfaqësuesit të Komisionit të Venecias, në Simpoziumin e mbajtur, Kryetari Hasani mbajti një fjalim përkitazi me zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese në Evropë, si dhe për bashkëpunimin ndërmjet Komisionit të Venecias dhe vendeve arabe, bazuar në Marrëveshjen e nënshkruar në Kajro, në vitin 2009, ndërmjet Unionit të Gjykatave dhe Këshillave Kushtetuese të Vendeve Arabe (UACCC) dhe Komisionit të Venecias.

Në kuadër të Simpoziumit të mbajtur në Kuvajt, kryetari Hasani u prit në takim zyrtar edhe nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kuvajtit, z. Yousef Al-Moutawah.

6 - 8 prill 2015

Kryetari Hasani ka mbajtur takime me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, me Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, z. Bashkim Dedja, si dhe me Kryetarin e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, Prof. Dr. Xhezair Zaganjori.

Kryetari Hasani u prit në takim edhe nga Rektori i Universitetit të Tiranës, z. Dhori Kule, ku para akademikëve dhe studentëve të Fakultetit Juridik mbajti një ligjëratë lidhur me zhvillimet e fundit në Gjyqësinë Kushtetuese të Kosovës.

Në vijim të vizitës, Kryetari Hasani është takuar me Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta, si dhe me Ministrin e Drejtësisë të këtij vendi, z. Nasip Naço.

27 - 28 prill 2015

Kryetari Hasani dhe delegacioni i Gjykatës Kushtetuese janë ftuar për të marrë pjesë në simpoziumin ndërkombëtar me temë: *“Vlerësimi i aktgjykimeve në parashitresat individuale – sfidat dhe mjetet juridike”*, i cili u mbajt në Ankara të Turqisë.

Simpoziumi u organizua me rastin e kremtimit të përvjetorit të 53-të të themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë. Gjatë vizitës në Ankara, Kryetari Hasani u takua edhe me Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, z. Zühtü Arslan.

8 - 9 qershor 2015

Kryetari Hasani zhvilloi një vizitë pune dyditore në Tiranë, ku zhvilloi takime me udhëheqësit më të lartë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

10 - 15 qershor 2015

Me ftesë nga Gjykata e Kontesteve Juridiksionale të Republikës së Turqisë, Kryetari Hasani dhe gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, Dr. Altay Suroy, morën pjesë në Simpoziumin Ndërkombëtar, me rastin e 70 vjetorit të Gjykatës të Kontesteve Juridiksionale, në Ankara të Turqisë.

19 - 20 qershor 2015

Kryetari Hasani ka marrë pjesë si anëtar përfaqësues i Republikës së Kosovës në Sesionin e 103-të Plenar të Komisionit të Venecias, të mbajtur në Venecie të Italisë.

Kryetari Hasani mori pjesë si panelist edhe në punimet e dy nënkomisioneve të Komisionit të Venecias: atë për institucionet demokratike dhe atë për të drejtat themelore.

16 shtator 2015

Kryetarja Rama – Hajrizi, ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në Tiranë.

Kryetarja Rama - Hajrizi u prit nga homologu i saj, z. Bashkim Dedja.

Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i përvojave të ndërsjella në raportet ndërmjet Gjykatave Kushtetuese dhe Gjykatave Supreme të të dyja vendeve.

19 - 23 tetor 2015

Gjykata Kushtetuese në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman për Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar (IRZ), realizuan një vizitë studimore të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme Federale në Gjermani.

Gjatë qëndrimit në Karlsruhe të Gjermanisë, Kryetarja, Arta Rama Hajrizi dhe delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës takohen me zëvendëskryetarin Prof. Dr. Ferdinand Kirchhof si dhe me gjyqtarët Prof. Dr. Andreas L. Paulus, Prof. Dr. Doris König, M. C. L. dhe Prof. Dr. Susanne Baer të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese zhvilloi takime edhe me gjyqtarët e Gjykatës Supreme Federale të Gjermanisë si dhe me z. Hesse Dr. Günter Paul, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Landit, në Wiesbaden të Gjermanisë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i përvojave të ndërsjella në raportet ndërmjet Gjykatave Kushtetuese dhe Gjykatave Supreme të të dyja vendeve.

Vizita është mundësuar me përkrahjen e Fondacionit Gjerman për Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar sh. r. (IRZ)

2 - 6 nëntor 2015

Gjykata Kushtetuese, në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, realizuan një vizitë studimore në Këshillin e Evropës dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg të Francës. Delegacioni i Gjykatës përbëhej nga Kryetarja Rama – Hajrizi, Njësia Ligjore dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Përgjatë vizitës, delegacioni nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës u takua me zëvendëskryetarin e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut z. András Sajó si dhe me gjyqtarin z. Ledi Bianku, gjyqtar i Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut i zgjedhur në emër të Republikës së Shqipërisë.

Kryetarja Rama - Hajrizi, ka zhvilluar edhe takim me Kryetarin e Komisionit të Venecias z. Gianni Buquicchio, si dhe me zyrtarë të ndryshëm nga Këshilli i Evropës dhe Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Vizita është mundësuar me përkrahjen të Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë.

II. Vizita zyrtare në Gjykatën Kushtetuese/Aktivitete të tjera

9- 10 mars 2015

Një delegacion i Këshillit Shtetëror të Francës, i prirë nga Kryetarja e Seksionit të studimeve dhe raporteve, znj. Maryvonne de Saint Pulgent, vizituan Gjykatën Kushtetuese.

Delegacioni francez, i kryesuar nga znj. de Saint Pulgent, u prit në takim nga kryetari Hasani.

Gjatë takimit, kryetari Hasani fillimisht e njohu znj. de Saint Pulgent dhe delegacionin francez me punën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese, si dhe për bashkëpunimin me institucionet e tjera homologe në rajon dhe më gjerë. Ai veçoi marrëdhëniet e mira bilaterale, posaçërisht me Këshillin Kushtetues të Francës, duke falënderuar shtetin francez për kontributin e dhënë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, si dhe për forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Znj. de Saint Pulgent, nga ana e saj, çmoi pozitivisht profesionalizmin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe vuri theksin në pavarësinë e domosdoshme të gjyqësorit, si parakusht për zhvillimin e mëtejshëm të shtetit ligjor dhe të demokracisë.

Të dyja palët shprehën vullnetin e përbashkët për forcimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes reciprok.

8 prill 2015

Gjykata Kushtetuese, në bashkëpunim me Institutin Gjyqësor të Kosovës, organizoi punëtorinë me temë: *“Roli i Gjykatës Kushtetuese në raport me gjykatat e rregullta sipas neneve 113.7 dhe 113.8 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës”*.

Qëllimi i punëtorisë, ishte informimi i kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm të Republikës së Kosovës, lidhur me rolin e Gjykatës Kushtetuese në raport me organet e tjera të pushtetit, si dhe me procedurat e punës në këtë Gjykatë.

21 maj 2015

Në seancën e mbajtur më datë 15 maj 2015, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës kanë zgjedhur gjyqtaren, mr. sc. Arta Rama-Hajrizi, kryetare të Gjykatës Kushtetuese, në përputhje me nenin 114, pika 5, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Znj. Arta Rama-Hajrizi mori postin e Kryetares së Gjykatës Kushtetuese, më 26 qershor 2015.

27 - 29 maj 2015

Një delegacion i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga këshilltarë juridikë dhe punonjës administrativë të këtij institucioni, kryen një vizitë studimore në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nga 27 deri më 29 maj 2015.

Gjatë vizitës, delegacioni i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë u informua lidhur me organizimin dhe me metodat e punës së Njësive Ligjore dhe të departamenteve të tjera që funksionojnë në kuadër të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

16 qershor 2015

Më 16 qershor të vitit 2015, me rastin e përfundimit të mandatit të Kryetarit Hasani, në Prishtinë, u mbajt një ceremoni e lamtumirës.

Në këtë ceremoni, morën pjesë zyrtarë shtetërorë të vendit, përfaqësues të misioneve diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare në Kosovë, si dhe delegacione të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, dhe të gjykatave kushtetuese të Turqisë, Bullgarisë, Polonisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Me fjalë rasti, pjesëmarrësve në këtë ceremoni, iu drejtua Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Prof. Dr. Enver Hasani, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Prof. Dr. Fejzullah Hasani, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, z. Bashkim Dedja, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë, Prof. Dr. Dimitar Tokushev, si dhe Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë, znj. Elena Gosheva.

30 shtator 2015

Gjykatën Kushtetuese e vizituan studentë të Fakultetit Juridik të Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan.

Studentët u pritën në gjykatoren e Gjykatës Kushtetuese nga Këshilltari i Parë Ligjor, z. Sevdail Kastrati, këshilltaret znj. Amantina Tolaj dhe znj. Arbana Beqiri-Plakolli.

5 tetor 2015

Një delegacion i Gjykatës së Kontesteve Juridiksioneve të Republikës së Turqisë kreu një vizitë në Gjykatën Kushtetuese. Kryetarja Rama - Hajrizi mirëpriti delegacionin në krye me Kryetarin e kësaj gjykate, z. Serdar Ozguldur, në Gjykatën Kushtetuese.

Gjatë bashkëbisedimit, të dy kryetarët shkëmbyen përvoja midis dy gjykatave.

16 tetor 2015

Gjykata Kushtetuese shënon Vitin e Gjashtë Gjyqësor, me një ceremoni solemne organizuar në Prishtinë.

Në këtë solemnitet, morën pjesë delegacionet të Komisionit të Venedikut dhe të gjykatave kushtetuese të Sllovenisë, Shqipërisë, Turqisë, Lituanisë, Bullgarisë, Malit të Zi, të Maqedonisë, si dhe përfaqësues nga Gjykata e Lartë e Shqipërisë.

Me një fjalim rasti, pjesëmarrësve në këtë ceremoni iu drejtua Kryetarja Rama – Hajrizi, Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj, znj. Atifete Jahjaga si dhe Kryetari i Komisionit të Venedikut z. Gianni Buquicchio.

Gjatë qëndrimit të Kryetarit të Komisionit të Venedikut, në Republikën e Kosovës, Kryetarja Rama- Hajrizi dhe z. Gianni Buquicchio, zhvilluan takime me udhëheqësit shtetërorë të vendit, Shkëlqesinë e Saj znj. Atifete Jahjaga, Kryeministrin z. Isa Mustafa si dhe me Ministrin e Drejtësisë z. Hajredin Kuçi.

19 - 23 tetor 2015

Znj. Suzana Krasniqi, Këshilltare juridike në Gjykatën Kushtetuese realizoi një vizitë studimore në Këshillin e Shtetit Francez, më 19 - 23 tetor 2015.

Vizita studimore është mundësuar me koordinim me Ambasadën e Francës në Kosovë dhe me mbështetje financiare nga Projekti për Reformë Ligjore Gjermane (GIZ).

13 nëntor 2015

Gjykatën Kushtetuese e vizituan një grup studentësh nga Universiteti *Isa Boletini*, Mitrovicë. Qëllimi i kësaj vizite ishte njoftimi rreth punës dhe kompetencave të Gjykatës Kushtetuese.

Nëntor 2015

Gjykatës Kushtetuese iu siguroa qasje e vazhdueshme në bazën e dhënave të literaturës juridike “WESTLAW”, nga Kompania “Thomson Reuters”.

III. Seminare pune

21 - 22 prill 2015

Gjykata Kushtetuese, në bashkëpunim me Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës dhe me përkrahjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (IRZ), organizoi punëtorinë në temën: *“Inkurajimi i referimit të kërkesave nga Gjykata Supreme dhe gjykatat e tjera të rregullta të Republikës së Kosovës në Gjykatën Kushtetuese/Si të rritet ndjeshmëria e Gjykatës Supreme dhe gjykatave të tjera të rregullta që të dorëzojnë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese?”*, në Budva të Malit të Zi.

Kjo punëtori, u organizua në vazhden e takimeve të rregullta dhe të bashkëpunimit të mirë ndërinstitucional ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe kishte për qëllim shkëmbimin e mëtejshëm të përvojave të gjyqtarëve të të dy gjykatave përkitazi me parashtrimin e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Folës dhe moderatorë të punëtorisë, ishin Prof. Dr. Ulrich Karpen, Profesor dhe Dekan i Departamentit të së Drejtës Publike dhe i Shkencave Politike në Universitetin e Hamburgut, dhe Prof. Dr. Matthias Hartwig, Profesor i së Drejtës Kushtetuese në Universitetin e Heidelbergut në Gjermani.

7 - 8 maj 2015

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, një delegacion i këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetuese morën pjesë në konferencën rajonale me temë: *“Veçoritë e procesit vendimmarrës para Gjykatës Kushtetuese”*, e cila u mbajt në Lezhë të Shqipërisë.

Në këtë konferencë, krahas këshilltarëve juridikë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, morën pjesë edhe homologë të Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi dhe të Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë. Konferenca u organizua në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman “Hanns Seidel”.

20 - 21 maj 2015

Gjykata Kushtetuese, në bashkëpunim me Projektin për Reformë Ligjore Gjermane (GIZ), organizoi në Prishtinë punëtorinë në temën: *“Procedurat dhe masat disiplinore për gjyqtarët dhe këshilltarët juridikë”*.

Në këtë punëtori, u trajtua tema e procedurave dhe e masave disiplinore për gjyqtarët dhe për këshilltarët juridikë në Gjykatën Kushtetuese të Gjermanisë, në Gjykatën Kushtetuese të Austrisë dhe në Gjykatën Kushtetuese të Spanjës.

Moderator i punëtorisë ishte Këshilltari juridik në Gjykatën Kushtetuese të Gjermanisë, Dr. Thorsten Ehrbeck.

Prill/ dhjetor 2015

Me përkrahjen e Projektit të Këshillit të Evropës për Mbështetje në zbatimin e standardeve Evropiane për të drejtat e njeriut, mbahen seminarët për këshilltarët juridik të Gjykatës Kushtetuese mbi temat:

1. *“Të drejtën për gjykim në kohë të arsyeshme dhe të drejtën për mjete efektive në lidhje me tejzgjatjen e procedurës në bazë të KEDNJ”*, më 30 prill 2015, në Prishtinë;
2. *“Kriteret e Pranueshmërisë dhe nenit 5 i Konventës”*, më 25 - 26 maj 2015, në Prishtinë;
3. *“E drejta për Gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së: Aspekti Civil”*, më 28 maj 2015, në Prishtinë;
4. *“E drejta për Gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së: Aspekti Kriminal”*, më 1 qershor 2015, në Prishtinë;
5. *“E drejta e pronës sipas nenit 1 të protokollit të Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut”*, më 21 shtator 2015, në Prishtinë;
6. *“E drejta e Lirisë së shprehjes sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, më 23 tetor 2015, në Prishtinë;
7. *“Neni 8 të Konventës për të Drejtat e Njeriut, - përmbledhja, parimet dhe rastet kryesore”*; më 17 dhjetor 2015, në Prishtinë;

15- 18 shtator 2015

Gjykata Kushtetuese ka mbajtur në Durrës të Shqipërisë punëtorinë e Planit të Veprimit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese.

28 - 30 tetor 2015

Gjykata Kushtetuese, në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë organizoi tryezën e përbashkët mbi temën: *“Aspekte të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative të Gjykatës Kushtetuese - Paraqitje e elementëve dallues dhe të përbashkët në mes të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”*.

Tryeza e përbashkët u kryesua nga sekretarët e përgjithshëm. Pjesëmarrës ishin zyrtar të të dy gjykatave. Tryeza është organizuar në Shkup të Maqedonisë.

16 - 17 nëntor 2015

Gjykata Kushtetuese, në bashkëpunim me Projektin për Reformë Ligjore Gjermane (GIZ), organizoi punëtorinë me temën “Hartimi Ligjor”. Ligjërues të punëtorisë ishin Dr. Steffen Wesche dhe Dr. Ingeborg Darsow Faller, ndërkaq, në punëtori morën pjesë këshilltarët juridikë të Gjykatës Kushtetuese.

SHTOJCA

SHTOJCA

Përmbledhje e llogarive të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2015
Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme

Shën.	2015			2014			2013		
	Llogaria e vetme e Thesarit			Llogaria e vetme e Thesarit			Llogaria e vetme e Thesarit		
	BKK	THV	Pagesat nga palët e treta të jashtme	BKK	THV	Pagesat nga palët e treta të jashtme	BKK	THV	Pagesat nga palët e treta të jashtme
	€	€	€	€	€	€	€	€	€
Pranimet									
Ndarjet nga Fondi i përgjithshëm 2	1,406,124			1,384,900			1,527,704		
Të hyrat vetanake									
Ndarjet nga Fondi me qëllime të dedikuara 3									
Grantet e përcaktuara të donatorëve 4				84,600					
Fondi i huazimeve 5									
Pranimet e tjera 6									
Totali i pranimeve	1,406,124	-		1,469,500	-	-	1,527,704	-	-

Pagesat

Operacionet

Pagat dhe mëditjet 7	917,678		837,307		737,776
Mallrat dhe shërbimet 8	485,328		595,351		592,559
Shërbimet komunale 9	3,118		7,074		9,365
			1,439,732		1,339,700

Transferet

Transferet dhe subvencionet 10	1,406,124				101,042
--------------------------------	-----------	--	--	--	---------

Shpenzimet kapitale

Prona, ndërtesa dhe pajisjet 11			29,767		86,962
---------------------------------	--	--	--------	--	--------

Pagesat e tjera 12					
--------------------	--	--	--	--	--

Pagesat gjithsej	1,406,124	-		1,469,500		-	1,527,704		-
------------------	-----------	---	--	-----------	--	---	-----------	--	---

Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit

Shënime		2015				2014	2013
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Dallimi	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=C-B	E	F
		€	€	€	€	€	€
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Tatimet	14						
Të hyrat vetanake	15						
Grantet dhe ndihma	16	27,747		27,747	84,600		
Pranimet kapitale	17						
Fondi i privatizimit	18						
Huazimet	19						
Të tjera	20						
Pranimet totale të mbledhura për BKK		-	27,747		27,747	84,600	-
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	21	965,864	917,678	917,678	837,307	737,776	
Mallrat dhe shërbimet	22	496,806	515,118	485,328	(29,790)	595,351	592,559
Shërbimet komunale	23	7,500	4,095	3,118	(977)	7,074	9,365
Transferet dhe subvencionet	24						101,042
Shpenzimet kapitale	25					29,767	86,962
Fondi i privatizimit	26						
Të tjera	27						
Totali i pagesave i bërë nga BKK		1,470,170	1,436,892	1,406,124	(30,767)	1,469,500	1,527,704

ORGANOGRAMI



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

